

VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Sot, në datën 27/07/ 2022, në përputhje me Statutin e shoqërisë UNION BANK SH.A, shoqëri aksionare shqiptare, me NIPT K51807801R, me seli në adresën: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 9, Sheshi Ferenc Nopçka, Ndërtesa Nr. 5, Kodi postar 1016, (në vijim referuar si "Banka") dhe ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008. "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Aksionarët e Bankës të mbledhur në mbledhje me prezence fizike (në vijim referuar si "Mbledhja"):

- **Z. Edmond LEKA**, zotërues i aksioneve që korrespondojnë me 1.77% të kapitalit aksionar të Bankës;
- **Z. Niko LEKA**, zotërues i aksioneve që korrespondojnë me 1.77% të kapitalit aksionar të Bankës;
- **UNION FINANCIAR TIRANË SH.A**, një shoqëri shqiptare aksionare, me NIPT J62424002G, me seli në adresën: Rr.Ismail Qemali,Nr.32, Kati 3, Tiranë, zotëruese e aksioneve që korrespondojnë me 96.46% të kapitalit aksionar të Bankës, përfaqësuar nga administratori i saj, Z. Elton ÇOLLAKU;

Së bashku referuar si "**Aksionarët**", u mbledhën për të vendosur si Asamble e Përgjithshme e Aksionarëve ("**Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve**") sikundër përcaktohet në vijim.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

VËREN që:

- Aksionarët janë njoftuar në mënyrën e duhur për çështjet mbi të cilat duhet të vendosin përmes këtij vendimi të Asamblesë së Aksionarëve;
- Asambleja e Aksionarëve po merr vendim në lidhje me çështjet e specifikuar këtu në përputhje me Statutin e shoqërisë;
- Aksionaret e mbledhur në Mbledhje, kanë autorizimet e nevojshme, si dhe tagrat e nevojshme, për të miratuar dhe votuar në Mbledhje këtë vendim si Aksionarë ose në emër dhe për llogari të Aksionarëve.

DHE DUKE QENË SE është mbledhur për të vendosur mbi çështjet e mëposhtme:

1. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Bankës me një shumë prej 10 milion Euro (dhjetë milion) nga fitimet e akumuluar dhe të paspërndara në përputhje me parashikimet e nenit 177 dhe 178 të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Në përfundim të këtij procesi vlera nominale e aksioneve të Union Bank sh.a. nga 20,971,430.00 Euro, bëhet 30,971,430.00 Euro. Këtij Vendimi i bashkangjiten bilanci i shoqërisë, konfirmimi i ekspertit kontabël të

Bulevardi Zogu i Pare, Sheshi Ferenc Nopçka, Nd. 5, H. 3, Njesia 9, Tirane, Shoqëri



autorizuar dhe pasqyra e fundit e te ardhurave dhe shpenzimeve se bashku me deklaraten e Drejtorit Ekzekutiv lidhur me gjendjen e aktiveve te shoqërisë.

- (A) Asambleja e Përgjithshme me votë unanime –PRO- që përfaqëson 100% të të drejtave të votës në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve të Bankës vendosi të zhvillojë Mbledhjen dhe të marrë vendimet e mëposhtme pavarësisht formaliteteve të thirrjes së kësaj mbledhjeje:

VENDOSI:

1. Miratimin e zmadhimit te kapitalit aksionar të regjistruar të Bankës në shumën prej 10 milion Euro (dhjete milion euro), kundravlefte ne Leke 1,166,000,000.00 me kursin fiks te Bankes se Shqiperise te dates se ketij vendimi, me burim fitimet e akumuluar dhe të pashpërndara te viteve te meparshme financiare te Bankes. Ne përfundim te zmadhimit te lartpërmendur kapitali aksionar i regjistruar i shoqërisë behet 30,971,430.00 Euro me kundravlefte 3,883,812,263.88 Leke, nderkohe qe vlera nominale e aksionit ne Euro behet 14.77 me kundravlefte ne Leke 1,851.95.

(B) DEPOZITIMI I VENDIMIT

B.1.Asambleja e Aksionarëve vendosi të depozitohet ky vendim pranë Bankës së Shqipërisë për miratim dhe/ose pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tirane dhe autorizon Drejtorin Ekzekutiv të Bankës Znj.Flutura Veipi për ndjekjen e procedurave përkatëse për regjistrimin e këtij Vendimi apo që të delegojë tagrat e saj sipas këtij vendimi te çdo palë e tretë që ajo e konsideron të përshtatshme.

AKSIONARËT E SHOQËRISË

Z.Edmond LEKA

Z.Niko LEKA

UNION FINANCIAR TIRANË SH.A

Përfaqësuar nga administratori Z.Elton ÇOLLAKU

UNION FINANCIAR TIRANË sh.a.
Rruga "Iskulli Qemali" Nr.32
Kodi Postar 1019, Njesia Bashkloqe N. 5
NIPT : J62424002G

Për aksionarët dhe Bordin Drejtues të “Union Bank Sh.a”

21 tetor 2022

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 44 525 880
M +355 69 4014 701
www.grantthornton.al
contact@al.gt.com

Të nderuar Zotërinj,

Kemi kënaqësinë t'ju paraqesim raportin e ekspertit kontabël në lidhje me vendimin e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve dates 27/korrik/2022 për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Union Bank Sh.a. Gjeneri në vijim analizën tonë në lidhje me këtë çështje si dhe trajtimin kontabël.

Me respekt,

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

21 tetor 2022



Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 44 525 880
M +355 69 4014 701
www.grantthornton.al
contact@al.gt.com

Raport në Lidhje me Trajtimin Kontabël të Zmadhimit të Kapitalit

Drejtuar Aksionarëve dhe Bordit Drejtues të Union Bank Sh.a

Sipas Vendimit të Asamblesë së përgjithshme të Aksionarëve më datë 27 korrik 2022 në përputhje me Statutin e shoqërisë "Union Bank" Sh.a., (më poshtë referuar si Banka) me nipti K51807801R, e themeluar me datë 17/05/2005 në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, është vendosur për rritjen e kapitalit të regjistruar të Bankës nëpërmjet fitimit të akumuluar dhe të pashpërndarë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021.

Fitimi i pashpërndarë i Bankës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 siç është paraqitur në pasqyrat financiare të Bankës më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 në përputhje me nenin 47 të Ligjit për Bankat në Republikën e Shqipërisë (Ligji Nr 9662, datë 18 dhjetor 2006) ishte 1,795,841,984.44 Lek dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) ishte 2,954,301,858.75 Lek.

Më 27 korrik 2022, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vendosi rritjen e kapitalit të Bankës me një shumë prej 10 milion Euro (dhjetë milion) dhe kundravlehtë në Lekë 1,166,000,000.00 me kursin fiks të Bankës së Shqipërisë të datës së këtij vendimi, me burim fitimet e akumuluar dhe të pashpërndara të viteve të mëparshme financiare të Bankës, në përputhje me parashikimet e nenit 177 dhe 178 të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Gjendja e llogarive të kapitalit aksionar para dhe pas rritjes së kapitalit të paguar të Bankës në Pasqyrat Financiare të Bankës do të jetë si më poshtë:

	Gjendja më 31 dhjetor 2021	Gjendja më 31 dhjetor 2021	Rritja	Rritja	Gjendja më 27 korrik 2022	Gjendja më 27 korrik 2022
	EUR	LEK	EUR	LEK	EUR	LEK
Kapitali aksionar	20,971,430.00	2,717,812,263.88	10,000,000.00	1,166,000,000.00	30,971,430.00	3,883,812,263.88
TOTALI	20,971,430.00	2,717,812,263.88	10,000,000.00	1,166,000,000.00	30,971,430.00	3,883,812,263.88

Kursi i këmbimit i përdorur për rritjen e sipërpërmendur të kapitalit është kursi zyrtar i Bankës së Shqipërisë në datën 27 korrik 2022, ku 1.00 EUR = 116.60 Lek.

Gjendja e kapitalit aksionar më 31 dhjetor 2021 paraqitet në monedhën origjinale bazuar në kurset historike të këmbimit të datave kur janë bërë rritjet përkatëse të kapitalit.

Numri total i aksioneve të nënshkruara dhe të paguara Bankës para dhe pas rritjes së sipërpërmendur të kapitalit, është si në vazhdim:

Aksionari	Numri i aksioneve ekzistuese më 31 dhjetor 2021	Vlera për aksion në EUR	Vlera për aksion në LEK	Vlera e aksioneve ekzistuese më (në EUR) 31 dhjetor 2021	Vlera e aksioneve ekzistuese më (në Lek) 31 dhjetor 2021	%
Z. Edmond Leka	37,125.00	10.00	1,295.9594	371,250.00	48,112,494.14	1.77%
Z. Niko Leka	37,125.00	10.00	1,295.9594	371,250.00	48,112,494.14	1.77%
Unioni Financiar Tiranë Sh.a.	2,022,893.00	10.00	1,295.9594	20,228,930.00	2,621,587,275.60	96.46%
TOTALI	2,097,143.00			20,971,430.00	2,717,812,263.68	100%

Aksionari	Numri i aksioneve ekzistuese më 27 korrik 2022	Vlera për aksion në EUR	Vlera për aksion në LEK	Vlera e aksioneve ekzistuese më (në EUR) 27 korrik 2022	Vlera e aksioneve ekzistuese më (në Lek) 27 korrik 2022	%
Z. Edmond Leka	37,125.00	14.77	1,851.9540	548,250.00	68,753,790.42	1.77%
Z. Niko Leka	37,125.00	14.77	1,851.9540	548,250.00	68,753,790.42	1.77%
Unioni Financiar Tiranë Sh.a.	2,022,893.00	14.77	1,851.9540	29,874,930.00	3,746,304,683.04	96.46%
TOTALI	2,097,143.00			30,971,430.00	3,883,812,263.88	100%

Sipas regjistrimit të QKB-së nuk ka patur ndryshime të tjera për periudhën, nga 31 dhjetor 2021 deri më 27 korrik 2022.

Dokumentacioni

Ky raport është hartuar bazuar në dokumentat e dhëna nga drejtimi i Bankës Union Bank sh.a dhe të dhënave në Regjistrin Publik pranë QKB si më poshtë:

- Pasqyrat Financiare të audituara të Bankës për viten e mbyllur më 31 dhjetor 2021;
- Pasqyrat financiare të ndërmjetme të audituara të Bankës më 30 qershor 2022;
- Ekstraktin historik të Bankës në QKB;
- Vendimin e Asamblesë së përgjithshme të Aksionarëve të Bankës të dates 27 korrik 2022;

Kufizim në Përdorim

Ky raport është hartuar vetëm për qëllimin e rritjes së kapitalit aksionar të “Union Bank” Sh.a, dhe nuk duhet të përdoret për qëllime të tjera. Deri në datën e lëshimit të këtij raporti, rritja e kapitalit nuk ishte regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
21 tetor 2022

